



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



REND DITE:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Prishtinës nga Policia e Kosovës;
3. Informatë mbi punën e Këshillave Lokal të Sigurisë Publike në Prishtinës (KLSP);
4. Informatë nga Drejtoria e shërbimeve Publike lidhur me mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve për sezonin e dimrit, ndriçimit publik, pastrimin e pusetave të ujërave atmosferike, qenë endacak etj.
5. Të ndryshme

Selim Pacolli nënkryetar i Komunës e hapi mbledhjen duke i përshëndet të pranishmit, dhe i njoftojë me rendin e ditës.

Pika e parë e Procesverbalit i mbledhjes së kaluar u miratua nga të pranishmit të KKSB-së.

Pika e dytë e rendit të ditës, Informatë lidhur me gjendjen e sigurisë në Komunën e Prishtinës nga P.K. në këtë pikë të rendit të ditës raportuan tre Komandantet e Stacioneve të Policisë.

Isak Ejupi komandant i stacionit policor të veriut i njoftoj të pranishmit se kanë zhvilluar një analizë për siguri dhe ka dalë se gjendja e sigurisë është e qetë dhe stabile, ka një rënie të veprave penale, por gjithsesi jemi duke vazhduar me aktivitete operative dhe po ka rezultate të mira. Ne emër të stafit të Stacionit Policor të veriut personalisht falënderojë nënkryetarin e Komunës z.Selim Pacolli në kontributin e dhënë për finalizimin e ndarjes së parcelës për ndërtimin e stacionit policor sepse kemi punuar në kushte shumë të vështira pa hapësirë të duhur.

Selim Pacolli- nënkryetar i komunës tha se edhe në kuvendin e komunës ka pas një unitet të madh rreth dhënies së parcelës për ndërtimin e stacionit policor kur është aprovuar nga deputete me 33 vota asnjë abstenim asnjë kundër 20 ari vend 1770m2.

Gani Berisha komandant i stacionit policor -jugu gjatë këtij muaji gjendja e sigurisë ka qenë e mirë, por ka pas disa probleme rreth fillimit të linjave të reja të qarkullimit të autobusëve të trafikut urban dhe protestave nga operatorët privat të linjave të autobusëve, kemi pas angazhime tjera rreth mbajtjes së aktiviteteve sportive. Pastaj angazhime shtese të rruga "Muharrem Fejza" dhe të disa vendkalimi. Pastaj angazhimet tona neper shkolla me aksionin "Stop droga në shkolla" dhe plane operative me agjensione tjera shtetërore. Kemi pas disa aksione për të luftuar veprat e renda penale ku dhe ka rezultuar me nxënien e tyre dhe burgosjen e kryerësve dhe se gjate këtij aksioni janë lënduar edhe 5 policë.

Problem tjetër janë veturat e parkuara me muaj apo vite , te ish stacioni i vjetër i autobusëve është bere një punë e mire dhe është vënë rrethoja , te vendkalimit e këmbësore te jete mundësia për vënien e semaforëve për vëzhguar situatën më mirë ne trafik dhe po ka tollovi lidhur këtë të merren masa te “Pro Credit”.

Selim Pacolli nënkryetar i Komunës tha se duhet bërë plane afatgjate të ketë shumë mundësi për nënkalime e të cilat te shfrytëzueshme dhe të planifikuara .Taksitë ilegal po na shkaktojnë problem edhe me linjat nder urbane si Podujeve -Prishtinë te cilët nuk hyjnë në stacion te autobusëve dhe ndalen vend e pa vend shkaktojnë parregullsi të trafikut . Ndalimi i taksive ilegal duhet të kemi angazhim më të madh të Inspektionit, me planin për zgjerimi te parkingjeve do te ketë me shumë vende parkingje në Dardani. Gjithashtu propozojë qe te hënave te jene prezentë policia te shkolla e mjekësisë qe te drejtojnë edhe fizikisht komunikacionin .

Faton Shala Shef i operatives së stacionit policor -Qendra i përshëndeti te pranishmit dhe i njoftoj se në të gjitha aktivitete ka rënie dhe se gjendjen e sigurisë e vlerësojë të qete .Po ka bllokim të rrugës me parkingje në hapësirë që pengojnë qasjen e qytetareve , mungesa e merimangës për tërheqjen e automjeteve po shkakton probleme në komunikacion sepse nuk po kemi mundësi për largimin e veturave .

Dejan Millutinoviq Përfaqësues i komunitetit serb ai tha se gjendja e sigurisë është e qetë dhe se nuk eksese, por e pyes komandantin e policisë te regjionit se deri ku ka arrit rasti për zbulimin e kryerësve te kësaj vepre te vjedhjes së qirinjeve në kishën e Bardhoshit.

Isak Ejupi komandant i stacionit policor me shqetësim e kemi marre lajmin dhe e kemi trajtua me seriozitetin më të madh për shkak te efekteve ndërnacionale, ku aty ka pas para dhe nuk janë marre por janë vjedhur vetëm qirinjtë , është një dilemë e madhe këtu, ne kemi formuar ekip te posaçme për ta trajtuar rastin më me intensitet, dhe se ky nuk është rasti i vetëm që në kultet fetare, ka pas vjedhje edhe dy raste tjera në xhami.

Hetem Kupina KLSP- Bardhosh unë pas policisë kam shkuar dhe kam biseduar me komandantin e nën stacionit në Bardhosh lidhur me rastin e vjedhjes në bazë të bisedës nuk mendoje se ka pas karakter ndërnacional, këtë çështje e kemi ngrit dhe kemi dënuar edhe ne në KLSP s’ka njeri qe për krahu këtë akt të shëmtuar.

Selim Pacolli nënkryetar i komunës -objektet e kuteve fetare janë te ndjeshme dhe duhet së shpejti te trajtohet ky rasti i shëmtuar .

Pika e trete Informatë mbi punën e Këshillave Lokal të Sigurisë Publike në Prishtinë (KLSP);

Hetem Kupina KLSP-Bardhosh jemi të thirrur me i përcjell zhvillimet dhe sfidat takimet e KLSP i mbajmë çdo muaj 12 takime ne vit te rregullta , ndërsa 4 tjera te jashtëzakonshme. I mbajmë me kryesuesit e BL; me drejtoret e shkollave ; me këshillin e prindërve ; përfaqësuesit fetar ; te bizneseve ; te forumit rinor dhe forumit të gruas . Ku kemi shtjelluar temat e ndryshme si parandalimin e ekstremizmit fetar dhe radikalizmit te dhunshëm, dukurinë e fajdesë, pastaj keqpërdorimin e femrave Pastaj kemi mungese të psikologut në shkolla me mbi 1000 nxënës nevojitet psikologu. Kemi mungese te këndit te lodrave ,pastaj mungesa e sallave te sportit. Bashkëpunimi me OSCE ku shume projekte kemi realizuar .Mungesa e sinjali stikës për peronat me aftësi të kufizuar. Ligjërimi fetar i paautorizuar, mungesa e ndriçimit publik, këtu pati një lëvdatë për SHP lidhur me ndriçimin .Bërnica e poshtme është ndriçuar mire me përjashtim te disa poqeve qe janë djegur e të cilat së shpejti do zëvendësohen .Ne duhet të punojmë mbi 10 vjet nuk është punuar më mirë KLSP-ja jonë është shpalle më e suksesshmja.

Ilmi Uka KLSP-Keqekolle ai tha se nuk pajtohem me parafolësin se KLSP – Bardhosh është e para sepse te gjitha janë formuar po thuajse përnjëherë te gjithë jemi për një mirëqenie të banoreve dhe për paraqitjen sfidave dhe problemet tona.

KLSP përfshin 8 fshatra ,(3) tri BL në Keqekollë , tri në Dabishec dhe dy BL në Koliq Mbledhje i mbajmë gjithmonë me përfaqësuesit dhe me te gjithë qytetarët që shprehin interesim kemi bashkëpunim me policinë e stacionit të veriut pastaj aty shpesh i mbajmë mbledhjet , pastaj mbajmë edhe ato te propozuara nga vet qytetarët që kane ndonjë kërkesë të veçantë të cilat i mbajmë në qytet ne mbledhje e ftojmë edhe KFOR-in të cilët i falënderojmë për prezencën dhe kontributin e tyre ,pastaj me drejtoret e shkollave sipas nevojës .Takime të jashtëzakonshme sipas nevojës siç ishte ajo shkaku i rrjetit të transportit ku me 1 tetor kemi pas takim me Habib Qorrin udhëheqës i SHP në fshatin Keqe kollë po vjen 4 herë në ditë autobusi, në planin operative të përfshihen edhe 8 (tetë) fshatrat tjera të Gollakut , ku shumë punetore fizikë shkojnë dhe punojnë në magjistralen Prishtine –Leskovc te gurthyesi. Me 1 shtator ka pas grevë . Unë si Perfaqesues i tyre kam shkuar për të biseduar dhe i kam bind ta ndërrojnë qasjen dhe se kete kërkesë do ta përcjellë te ekzekutiv komunal dhe brenda mundësive do të realizohet . Problem tjetër i cili është aktualizuar është preja e pyjeve pa kontroll ,fshataret e kanë prerë me masë për të mbajtur familjet e tyre dhe ne duhet ti ndjekim tregtarët e jo fshatarët , pronareve tu epet një dokument si dëshmi se ata qe kane mbete aty janë shumë të varfër .Fshatrat gjenden rreth pronave kontestuese ku shpesh here ka problem që vjen deri te përdorja e armeve si mjet i zgjidhjes se zënkave dhe ne si KLSP ballafaqohemi çdo ditë dhe duhet të lajmërohet policia ku shpesh nxënësit dhe kalimtarët mund të jenë pre e këtyre problemeve .

Selim Pacolli nënkryetar i komunës do ti përgjigjem kërkesës për linjën e autobusëve ku do te lëshohet linja për fshatrat e gollakut hajkobille e deri te kufiri në Marec , nuk dua ta fajësoi asnjë kolege timin por qasja ndaj kërkesave te qytetareve ka tash një fryme te re për atë zonë, si plani për autobus dhe çështja e prerjeve e pyjeve në formë të pa kontrolluara nuk do të lejohet.

Ilmi Uka e falënderojë nënkryetarin për marrjen e hapave konkret si autobusi ku kjo do të ndikojë që të kthehen banorët varësisht investimeve.

Violeta Hasani KLSP Qendra – gjatë takimit të fundit KLSP –Qendra, banoret kanë identifikuar 3 lokale të zhurmshme në rrugën “Rexhep Luci “STRIP DEPO” “BABELLA “ dhe rrugën “Nurije Zeka “ Lulu Kafe” e të cilat tri herë në javë organizojnë muzikë të gjallë dhe i pengojnë qytetarët për një jetë normale. Nga takimi i fundit disa banorë te lagjes kërkuan që ta realizojnë një takim me kryetarin pikërisht për problemin e zhurmës , por si përfaqësuese e tyre nuk u pajtuam me kërkesën e tyre për shkak se kryetari njoftohet nëpërmes takimeve te KKSb-së.Znj Hasani prezantoi dy projekte të realizuara nga Ambasada Norvegjeze qe janë implementuar neper mes të OSCE dhe tri projekte me vetëfinancimin e banorëve duke u bere organizimi i tyre nëpërmes takime tona te rregullta , njëherit falënderon dhe është mirënjohëse në emër te komunitetit –Qendra por edhe ne emrin tim personal për nënkryetarin e komunës dhe drejtorinë e Administratës z.Muhedin Nushi i cili në vazhdimësi ka përkrahur KLSP- në duke na ndihmuar në zgjedhjen e problemeve gjatë realizimit te punëve dhe shërbimet publike z. Habib Qorrin qe ka kontribuar në të mire të banoreve . KLSP, Komunë , Polici janë bërë urë lidhëse në identifikimin dhe adresimin e problemeve të ndryshme .

Pika e katërt- Informatë nga Drejtoria e shërbimeve Publike lidhur me mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve për sezonin e dimrit , ndriçimit publik, pastrimin e pusetave të ujërave atmosferike, qenë endacak etj.

Ismajl Kokaj drejtor DSHPMSH po nisem pre asaj se kritikën që i marrim janë si bazë për përmirësimin falënderojë policinë për bashkëpunim , ne raste kur kemi pasur bllokime të mëdha të rrugëve ju gjithmonë na jeni gjendur për ta tejkaluar situatën dhe ju jap fjalën dy shefave të sektorit Fatmir Bilalli dhe Habib Qorri të cilët janë pjesë e kësaj mbledhje.

Hetem Kupina- Falënderojë SHP për kryerjen e punëve në ndriçimin dhe zgjerimin e ndriçimit ,transportin e rregullt , si dhe rreth mirëmbajtjes së rrugëve në sezonin dimëror të vitit të kaluar ku kanë zhblokuar rrugët dhe kanë punuar intensiv me kompanitë .

Habib Qorri informojë lidhur me shërbimin me Merimangë ekzistojnë procedurat prokurimit sepse janë të stërgjatura kur ka ankesa nga kompanitë konkurruese, ku këto procedurat nuk mund të ndryshojnë është qeshje e prokurimit .Pothuajse drejtori i përmendi të gjitha ,rreth projekteve të planifikuara siç janë kontratat për zgjerim të ndriçimit ,pastaj kontratat për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve në qytet dhe në viset rurale . Tani jemi hy në sezonin e vjeshtës dhe kemi prapë shumë probleme rreth mbylljes së posetave , rrjedhjet e kanalizimit me të cilat duhet të merremi edhe pse nuk jemi në të ngarkuar si drejtori por se prapë kërkesat rreth tyre duhet trajtuar duke bashkëpunuar edhe me drejtoritë tjera përkatëse .

Ilmi Uka KLSP-Keqekollë tha se kemi qenë të kënaqur me punën e kompanive në sezonin e dimrit për hapjen e rrugëve por kripa po i dëmton rrugët me kubza.

Habib Qorri- edhe në këtë vit do të jetë e njëjta kontrate sepse ajo ka qenë tri vjeçare dhe se vitin e ardhshëm do të bëjmë incizimin e rrugëve me dy operatorë në tri pjesë ku do të bëjmë zgjerimin e rrugëve për mirëmbajtje edhe pse ne kemi operuar edhe në ato që nuk kanë qenë në kontratë.

Ismail Kokaj kemi bashkëpunuar shumë me operatorët e të cilët edhe pse nuk kanë qenë të parapara në kontratë për mirëmbajtje dimërore pavarësisht kësaj kompanitë tona i kanë kryer punët pa hezitim duke lënë anash mirëqenien e vet. Ekziston një hallke e mirë e bashkëpunimit. Një pjesë e fajit bie edhe në vozitësit që nuk kanë pasur pajisjet dimërore dhe nuk ju kanë përshtatur terrenit.

Fatmir Bilalli tha se automjetet janë pajisura me xhipies dhe ne shohim kamionët në vendin e ngjarjes ku operojnë .

Gani Berisha Stacione policor-Qendra sa i përket bashkëpunimit për periudhën e dimrit që ka të bëjë me mirëmbajtjen e rrugëve ka qenë në nivel shumë të mirë ndërinstitucional.

Klaudie Mula zyrtare për komunitet paraqiti rastin e një kërkesë të komuniteti ashkali lidhur me pajisje me shporta të mbeturinave në rrugën “Bedri Gjinj “ Carraleva “e cila kërkesë ka dalë si konkluzion në komunitetin e komuniteteve .

Hetem Kupina ju kish lutur ta shqyrtoni dhe brenda mundësive ta aprovojnë kërkesën e këtij komuniteti për pajisje me një shportë të mbeturinave. ai në emër të komunitet serb paraqiti kërkesën lidhur me vijën e trafikut urban nga Berrnicë të vazhdojë deri te kisha.

Habib Qorri – do ta shqyrtojmë kërkesën e komuniteti brenda mundësive teknike.

Sasha Mitrovic kërkojë që të jetë një linjë për komunitetin serb në relacion Berrnicë Graçanicë sepse kemi 22 qytetare që punojnë dhe kemi qarkullim në këtë drejtim.

Hetem Kupina transporti i qytetarëve për Berrnicën e Poshtme pika e parë transporti i nxënësve është zgjidhur, ndërsa tani është ai qytetarëve në-Kishnicë relacionin Graçanicë dhe anasjelltas .

Habib Qorri është duke punuar ne një plan të trafikut Urban dhe ndër urban dhe periferik ku përfshihet Fushe Kosova ,Obiliqi dhe Graçanicë, do të kete marrëveshje mes Ministrisë se Infrastrukturës dhe nivelit lokal për linja te reja , linjë të veçantë vetëm për një komunitet nuk do të kete .

Isak Ejupi komandant i stacionit te veriut tha se hartografia e rrugës qe shkon kah gjykatat eshte shume e ngarkuar pastaj ndërtimi i rrugëve te reja duhet te ju vihen shenjat e komunikacionit , edhe pse shpesh ato dëmtohen dhe hiqen nga qytetaret papërgjegjshëm, taksit ilegal po shkatojnr tollovi ne trafik Inspekcioni duhet te kontrolloje dhe të gjobiten.

Premtime Preniqi zyrtare për drejtat e njeriut paraqiti problemin e kthesës te rrugës “Vëllezërit Gervalla “ka dëmtime të shtyllave antiparking ka vështirësi për vozitësit .

Shejlla Rexhepagiq – nga komuniteti boshnjak paraqiti një kërkesë e cila nuk i përket problematikave te cilat i trajton KKSb-ja .

Procesmbajtsja

Hateme Gashi

Kryesuesi i Mbledhjes së KKSb-së

Shpend Ahmeti